




Re.l.nr.645/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DRAGASH, gjyqtari Bekri Vehapi në procedurën kundërvajtse kundër të pandehures Luljeta Berisha nga fshati Buqe komuna e Dragashit, për kundërvajtje sipas nenit 17 pika 1. të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë të zyrtarve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e dhuratave për gjithë prsonat zyrtar, Ligji nr.04/L-050, e në bazë të nenit 73, 74 dhe neni 195 par. 1 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datën 11.12.2012, merrë këtë

A K T V E N D I M

E PANDEHURA Luljeta Myrtezan Berisha, e lindur 19.04.1975 në fshatin Brezne, komuna e Dragashit, Shqiptare, Shtetasë i Republikës së Kosovës, e martuar nën e 3 femijve, arsimtare, këshilltare në asamblen komunale në Dragash, me banim të përhershëm në fshatin Buqe komuna e Dragashit.

ËSHTË PËRGJEGJËS

Për arsye se si zyrtare e lartë, pikrisht si këshilltare në Asamblen komunale në Dragash, në afatin e përcaktuar ligjor, gjegjësisht deri me 31.mars të vitit 2012, nuk e ka përmbushur obligimin ligjor, nuk e ka plotësuar dhe dorzuar formularin për deklarimin e pasurisë, Agjencionit kundër korrupsionit të Kosovës në Prishtinë

Me që rast i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 6 pika 1 dhe 3. të sanksionuar sipas nenit 17 pika 1, të Ligjit nr.04/L-050, e në bazë të kësaj dispozite e konform nenit 9 par 1. të LMK-së, bëhet zbutja e denimit dhe e pandehura,

DENOHET

ME XHOBË, në shunën prej 50 (pesdhjeteuro)

E pandehura obligohet që xhobën ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmerisës këtij aktvendimi, në llogarin bankare përmes kësaj gjykate. Në të kundërtën do të bëhet arktimi i dhunshëm i xhobës me aktvendim të veçant.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 Euro, në afat prej 15 ditësh, njëjloj si edhe me xhobën.

A r s y e t i m

Me kërkesën e Agjencionit kundër korrupsionit të Kosovës në Prishtinë, 01-2156/2012, të dt. 04.06.2012, Gjykata për kundërvajtje me konkluzion e ka filluar procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Luljeta Berisha me të dhënat si në dispozitiv të aktvendimit.

E pandehura Luljeta Berisha në seancën e shqyrtimit verbal sipas proqesverbalit, gjegjësisht për mes deklarimit me shkrim ka deklaruar se nuk ka qenë i njoftuar me dispozitën ligjore dhe se nuk ka patur në dispozicion formularin për deklarimin e pasurisë, se për këtë qështje për herë të parë është njoftuar nga gjykata për kundërvajtje. Në pytjen e

03-4601/12/02
Bung

gjykatës ka deklaruar se si kshilltare në Asamblen komunale në Dragash, është nga viti 2009. Ka deklaruar se me të u njoftuar me obligimin ligjor, menjëher me dt. 15.08.2012 e ka paraqit formularin dhe njëherit e ka bërë deklarinimin e pasuris. Ka kërkuar nga gjykata që gjatë vendosjes të ketë parasysh faktet e prezentuara të cilat fakte do të shërbejnë si rrethana letësuese.

Gjykata për vërtetimin e sakt të rrethanave të kundërvajtjes, me dt. 07.12.2012, në seancën e shqyrtimit verbal e ka ndërguar deshmitarin, personin kontaktues Beqir Rashitin, i cili sipas procesverbalit ka deklaruar se me dt. 05.03.2012, përmes shkresës 02/Nr.zr, i ka njoftuar, njëherit dërguar edhe formularin e zbratur për deklarinimin e pasuris për vitin kalendarik 2011, të gjithë personat e të lartë zyrtar, njëherit edhe këshilltaren e Asambles komunale në Dragash, Luljeta Berisha. Deshmitari ka deklaruar se Luljeta Berisha formularin e plotësuar deri më datën 31.03.2012 edhe pasë kësaj date nuk më ka dorzuar mua si person kontaktues.

Gjykata ka lexuar shkresat së lëndës të Agjencionit kundër korrupsionit, deklaraten e të pandehurës, deklaraten e deshmitarit, deshmit e prezentuara dhe pa dyshim është konstatuar dhe vërtetuar se e pandehura Luljeta Berisha si zyrtare e lartë, si këshilltare e Asambles komunale në Dragash, e obliguar për ta deklaruar pasurin, në afatin e përcaktuar ligjor si në dispozitiv, nuk e ka plotësuar dhe nuk e ka dërguar formularin Agjencionit më së voni deri më dt.31.03.2012.

Me këto veprime ka kryer kundërvajtje nga neni 6.pik 1 dhe 3. të sanksionuar me nenin 17 pika 1. të Ligjit nr/04/L-050

Gjykata gjendjen faktike për vërtetimin e fajësis ndaj të pandehurës e ka vërtetuar nga deklarata bindëse e personit kontaktues Beqir Rashiti, si edhe nga vërtetimi se e pandehura formularin për deklarinimin e pasuris Agjencionit sipas i ja ka dërguar me vones me dt.15.08.2012.

Gjykata ndaj të pandehurës konform nenit 9 par.1 të LMK-së e ka bërë zbutjen e denimit nga rrethanat, se e pandehura për herë të parë ka kryer kundërvajtje të kësaj natyre, se është e gjendjes së dobët ekonomike, se në gjykat ka patur sjellje korrekte, se është penduar për kundërvajtjen e kryer, se me të kuptuar përgjegjësin dhe obligimin ligjor, me dt.15.08.2012, e ka plotësuar formularin dhe i ja dorzuar Agjencionit.

Me sa u tha me lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTEJE NË
DRAGASH, Me datën 11.12.2012, Re.Lnr.645/2012.

Gjyqëtar për kundërvajtje,
Behri Vehapi

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi parashtruesi i kërkesës dhe e pandehura kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e lartë për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa dërgohet me shkrim me 2.egzenplar pa taksa përmesë Gjykatës komunale për kundërvajtje në Dragash.